

POLITIKA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

WORLD VISION SHQIPËRI & KOSOVË

Përkufizimet:

Fëmijë – sipas legjislacionit të Shqipërisë dhe atij të Kosovës, çdo person nën moshën 18 vjeç.

Mbrojtja e Fëmijës: Të gjitha masat e marra për parandalimin dhe mbrojtjen në rast abuzimi, neglizhimi, shfrytëzimi dhe të gjitha format e tjera të dhunës kundër fëmijëve.

Incidenti i Mbrojtjes së Fëmijëve: 1) Shkelje e rëndë e të drejtave të fëmijës përse i përket mbrojtjes nga abuzimi fizik ose psikologjik, neglizhimit, shfrytëzimit, ose formave të tjera të dhunës – përfshirë trafikimin, shfrytëzimin seksual dhe për punë, dëmtimin e organeve gjenitale femërore dhe martesë në moshë të mitur.

2) Çdo shkelje e Politikës dhe Standardeve të Mbrojtjes së Fëmijëve e WVA&K që i vendos fëmijët në rrezik të drejtpërdrejtë dëmtimi.

3) Çdo vdekje ose dëmtim serioz i një fëmije që është nën përkujdesjen e përkohshme të WV, ose ndërkohë që merr pjesë në një veprimtari të WV, ose i shkaktuar nga personeli, vullnetar, praktikant, kontraktues, konsulent, vizitor, agjenci partnere ose donator/sponsor i WV.

Organizatë për mbrojtjen e fëmijëve: Një organizatë që është angazhuar për mbrojtjen e fëmijëve

Politika

Kjo politikë bazohet tek Politika e Bordit të World Vision International me titullin “Standardet e Partneritetit të World Vision për Mbrojtjen e Fëmijëve” që ka hyrë në fuqi në 2 Mars 2000, sikurse edhe tek Standardet e Rishikuara të WVI e miratuar në Nëntor 2012.

WVA&K merr në konsideratë ligjet e vendit lidhur me mbrojtjen e fëmijëve dhe konsultohet me avokatët e duhur ligjorë vendorë përse i përket zbatueshmërisë së ligjit të vendit. Në rast se politika e WVI nuk përputhet me ligjin e vendit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve lidhur me këtë çështje, mbizotëron ligji i vendit. Aty ku ligji i vendit përputhet me politikën e WVI ose është i heshtur, do të zbatohet politika e WVI.

Qëllimi:

Kjo politikë përcakton dhe përvijon rolet dhe përgjegjësitë e World Vision Albania dhe World Vision International në Kosovë WVA&K¹ (që këtu e më pas do të quhet WVA&K) për mbrojtjen e fëmijëve dhe familjeve të cilave u shërben, nga çdo dhunim i të drejtave të fëmijëve dhe për të ruajtur forcën punëtore që është e angazhuar për mirëqënien e fëmijëve në Shqipëri dhe Kosovë.

Objekti:

¹Në këtë dokument, çdo referencë e “WVA&K” nënkupton World Vision Albania dhe World Vision International në Kosovë.

Objekti kryesor i kësaj politike është të ruajë një organizatë të sigurt për fëmijët, e angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke ndërmarrë të gjitha hapat dhe masat e nevojshme. Kjo politikë zbatohet për të gjithë punonjësit e WVA&K, përfshirë të huajt, punonjësit kombëtarë dhe ata me kontratë, dhe mbulon të gjitha kategoritë e punësuar, përfshirë kontratat e pakufizuara, punonjësit në dispozicion, punonjësit me kohë të pjeshme dhe ata të përkohshëm, që kanë ndonjë lloj kontakti pune me, ose për fëmijët. Po ashtu ai gjen zbatim edhe tek konsulentët, kontraktuesit e pavarur, anëtarët e Bordit Kombëtar ose Bordit Këshillimor, stazhierët, vullnetarët dhe partnerët.

WVA&K është anëtar i një partneriteti ndërkombëtar i angazhuar për mirëqënien e fëmijëve në të gjithë botën. WVA&K është kundër të gjitha formave të shfrytëzimit të fëmijëve dhe abuzimit me fëmijët, përfshirë abuzimin seksual me fëmijët. Kjo Politikë përcakton standardet për Mbrojtjen e Fëmijëve nga WVA&K përsa i përket:

I. Rritjes së Ndërgjegjësimit

Çdo person që është në dijeni të ndonjë shqetësimi të mundshëm lidhur me mbrojtjen e fëmijëve ku është e përfshirë WVA&K, duhet të kontaktojë menjëherë Drejtuesin e Programit të Mbrojtjes së Fëmijëve, Drejtorin Kombëtar dhe Drejtorin e Zyra Mbështetëse.

I gjithë personeli i WVA&K, donatorët, vizitorët, vullnetarët/stazhierët dhe partnerët do të pajisen me informacion e duhur për mbrojtjen e fëmijëve dhe për të gjitha format kryesore të dhunimit të fëmijëve (psikologjik, fizik, seksual), përfshirë çështjet e shfrytëzimit të fëmijëve dhe trafikimin e fëmijëve.

- Kjo politikë kërkon që i gjithë personeli i WVA&K, donatorët, vizitorët WVI, partnerët dhe vullnetarët të jenë në dijeni, sipas nevojës, të Protokolleve të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të masave të tjera të mbrojtjes së fëmijëve;
- I gjithë personeli i WVA&K, vullnetarët/praktikantët, kontraktuesit dhe Anëtarët e Bordit Këshillimor njoftojnë me shkrim marrjen në dorëzim dhe të kuptuarit e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve të WVA&K, Protokolleve të Sjelljes të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe masat e tjera mbrojtëse sipas nevojës. Nëse ndonjëri prej individëve të lartpërmendur vihet në dijeni të ndonjë dëmtimi ose rreziku ndaj fëmijëve, ai duhet të informojë menjëherë WVA&K-në.
- Zyra Kombëtare (ZK) Skuadra MF, në koordinim me Departamentin Njerëz & Kulturë,² ka përgjegjësinë të sigurohet që i gjithë personeli të marrë orientimin dhe trajnimin e nevojshëm mbi Protokollet e Politikës Kombëtare të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Sjelljes, Përkufizimin e Mbrojtjes së Fëmijëve, Mekanizmat e Raportimit dhe përgjegjësitë dhe detyrimet e tjera në mbrojtje të fëmijëve. Për personelin e punësuar rishtazi kjo do të bëhet brenda tre muajve të parë nga marrja në punë, dhe bëhet të paktën një herë në dy vjet për personelin ekzistues.
 - Skuadra e MF, në koordinim me Departamentin Njerëz & Kulturë, do të trajnojnë, dhe Drejtuesit e ZL dhe partnerët për të dalluar “flamujt e kuq”: shenja ose sinjale që mund të sinjalizojnë dhunimin e mundshëm të një fëmije.

² Përfshirë, por jo i kufizuar nga Drejtuesit e ZL dhe Personeli i Sponsorshipit.

- Skuadra e MF do të koordinohet me Departamentin e Komunikimit për të siguruar trajnimin & ndërgjegjësimin e të gjithë personelit lidhur me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve përsa i përket përdorimit të medias sociale, përfshirë mekanizmat e raportimit për sjelljet e papërshtatshme ose keqpërdorimin e medias sociale. Ky trajnim duhet të kryhet të paktën një herë çdo dy vjet për të gjithë personelin dhe brenda tre muajve të parë nga marrja në punë për personelin e punësuar rishtazi.

2. Rekrutimi

2.1 Verifikimi dhe Përzgjedhja: Me qëllim që të sigurohet mbrojtja e fëmijëve të përfshirë në projektet tona, të gjithë punonjësit e mundshëm, vullnetarët, stazhierët, konsulentët, anëtarët e Bordit Këshillimordhe partnerët do të verifikohen për ndonjë dënim që lidhet me abuzimin ndaj fëmijëve, pedofili ose shkelje të ngjashme me to. Këto masa përfshijnë përmendjen e mbrojtjes së fëmijëve në formularët e aplikimit, në intervista dhe në referenca.

2.2 Verifikimi i Dokumentacionit dhe Dosjes Penale: Kandidatët për personel, anëtarë të Bordit Këshillimordhe vullnetarë/stazhierë të WVVA&K ose kontraktues, përgjegjësitë kontraktuale të të cilëve përfshijnë edhe ndërveprimin me fëmijët, ose afrimin me fëmijët, ose marrjen e informacionit personal të fëmijës, do t'i nënshtrohen verifikimit të identitetit dhe verifikimit të dokumentacionit/dosjes penale nga policia dhe Prokuroria para se të punësohen, ndërkohë që personeli nga Kosova duhet të paraqesë një deklaratë të dosjes penale nga gjykata(t) e vendeve ku ata banojnë dhe pas kësaj, në mënyrë periodike, sikurse kërkohet nga ligji ose konteksti. Njerëzit e dënuar më parë për një krim ndaj fëmijëve nuk duhet të punësohen apo angazhohen nga WVVA&K.

- Të gjithë individët do të këshillohen që, çdo dënim për abuzim me fëmijët, pedofili, dhunë kundër fëmijëve, trafikimin e qenieve njerëzore, dhunë në familje, ose shkelje të tjera të ngjashme, do të rezultojë në skualifikim nga shqyrtimi për t'u punësuar ose refuzimi për të vizituar një projekt.
- Kandidatët që do të punësohen në pozicione ndërhyrjeje në rast urgjencash apo ndihmash humanitare duhet të kalojnë përmes verifikimit nga policia të dokumentacionit dhe dosjes penale, ose në rastin e Kosovës, verifikimin e dosjes penale dhe dokumentacionit nga gjykata vendore, përpara se të pranohen si punonjës të WVVA&K.

3. Sponsorshipi

3.1 Parandalimi i Dëmtimit në Sponsorship: Sponsorshipi kryhet në një mënyrë të atillë që si përparësi kryesore të mbetet siguria e fëmijëve. Këtu përfshihet rishikimi i të gjithë korrespondencës me sponsorin, trajnimi i personelit dhe monitoruesve të fëmijëve për të dalluar dhe ndërhyrë në raste abuzimi, ndërveprimi konstruktiv me prindërit dhe fëmijët, dhe përdorimi i sigurt dhe ruajtja e informacionit personal.

3.2 Ndërhyrja në raste Abuzimi: Monitoruesit e sponsorshipit nxisin ndërmarrjen e veprimeve të duhura pasuese ose referimin e tyre nëse vërehen ose raportohen nevojat të

mbrojtjes së fëmijës, sikurse paraqitet tek Planet Kombëtare të Gatishmërisë ndaj Incidenteve në Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe në përputhje me ligjin vendor.

4. Vizitat në Projektet e WVA&K

4.1 Përgatitja e vizitës: Vizitat e Sponsorave ose donatorit janë të parapërgatitura nga zyra mbështetëse dhe zyra kombëtare. Zyrat mbështetëse kryejnë në polici verifikimet e dosjes penale dhe dokumentacionit për sponsorin ose donatorin e mundshëm vizitor para vizitës së tij në terren, aty ku ligji e lejon. Vizitat e palajmëruara tek fëmijët e sponsorizuar ose projektet komunitare të WVA&K nuk janë të lejuara.

4.2 Orientimi i Vizitorit për Mbrojtjen e Fëmijëve: WVA&K sigurohet që vizitorët të zbatojnë standardet e WVA&K për mbrojtjen e fëmijëve. Vizitorët të cilët vizitojnë një projekt ose kanë kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme.

- a) Vizitorët nga zyrat e tjera WV që janë personel ose Anëtarët e Këshillit: Zyra pritëse përgatit një orientim të shkurtër me shkrim ose me gojë për çdo Protokoll të përcaktuar Sjelljeje të Mbrojtjes së Fëmijëve, të zbatueshëm në atë kontekst, sikurse edhe mbi zakonet e vendit lidhur me ndërveprimin e të rriturve me fëmijët.
- b) Vizitorët që nuk janë personel i WV apo Anëtarë të Bordit: të gjithë vizitorët jo të punësuar do të informohen për Protokollin e Sjelljes së Mbrojtjes së Fëmijëve (Standardi 2) dhe Parandalimin e Dëmtimit në Komunikime (Standardi 1.4). Ata do të firmosin për njoftimin e marrjes në dorëzim të protokolleve, dhe marrëveshja e firmosur do të mbahet në një dosje nga personi që i mirëpret. Vizitorët që nuk janë personel shoqërohen nga një punonjës i WV gjatë vizitës në projekte.

5. Protokollet për Incidentet e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Ndërhyrjes

WVA&K duhet të hetojë dhe reagojë ndaj raportimeve për abuzim me fëmijët në zonat ku WV punon në mënyra që janë në përputhje me ligjin vendor. WV përdor tre nivele të Incidenteve të Mbrojtjes së Fëmijëve për të përcaktuar ndërhyrjen e WV, që bazohet tek përgjegjësia e mundshme e WV dhe rreziku i pasojave.

5.1 Incidenti i Nivelit I i Mbrojtjes së Fëmijëve: Konsiderohet çdo incident i mbrojtjes së fëmijëve që nuk kryhet nga ndonjë anëtar stafi/punonjës i WVA&K, anëtar i bordit/bordit këshillues, vullnetar, stazhier, kontraktues, konsulent, donator, sponsor, partner ose bashkëpunëtorë të tjerë të WV.

Zyra Kombëtare zhvillon dhe zbaton Planet e Gatishmërisë për Incidentet e Nivelit I të Mbrojtjes së Fëmijëve (PGIMF) ku përfshihen udhëzime specifike dhe praktike për përgjegjësitë, veprimet dhe kufizimet në përputhje me ligjin vendor, për skuadrat lokale të ndërhyrjes në rast të incidenteve të mbrojtjes së fëmijëve që ndodhin brenda komunitetit (për informacione të mëtejshme mbi mënyrën e trajtimit të incidenteve të Nivelit I referojuni PGIMF-së). Incidentet e Nivelit I raportohen tek Mbrojtja e Fëmijëve e WV në rastet e dëmtimeve serioze që kërcënojnë mbijetesën, sigurinë ose zhvillimin e fëmijës. Rasti duhet të raportohet me anë të

formularit elektronik të raportimit të Incidentit të Mbrojtjes së Fëmijëve brenda 72 orëve, me të gjithë informacionin e mbledhur

5.2 Incidenti i Nivelit II të Mbrojtjes së Fëmijëve: Konsiderohet çdo shkelje e Standardeve dhe Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve e WVA&K, që i vendos fëmijët përballë rrezikut të drejtpërdrejtë nga dëmtimi.

Me t'u informuar për incidentin, Drejtuesi i skuadrës do të informojë menjëherë Këshilltarin Teknik të MF, që më pas do t'ia transmetojë Drejtorit Kombëtar, dhe Këshilltarit të Sponsorshipit. Rasti duhet të raportohet në formularin elektronik të raportimit të Incidenteve të Mbrojtjes së Fëmijëve brenda 24 orëve, me të gjithë informacionin e mbledhur. Ndërhyrja zbatohet nga WVA&K e cila mban përgjegjësi edhe para Këshilltarit Rajonal për Mbrojtjen e Fëmijëve

5.3 Incidenti i Nivelit III të Mbrojtjes së Fëmijëve: Konsiderohet çdo pretendim për incident ose incident i mbrojtjes së fëmijëve në të cilin WV ka përgjegjësinë të ndërhyjë dhe/ose mbrojë dhe mund të ketë një masë rreziku nga pasojat. Një incident i Nivelit 3 në përgjithësi përfshin (i) një pretendim ose akuzë për dëmtim të një fëmije nga një person që ka lidhje me WV (p.sh: anëtar i personelit/punonjës, anëtar i bordit/bordit këshillimor, vullnetar, stazhier, kontraktues, konsulent, donator, sponsor, partner, etj.), dhe/ose (ii) vdekja ose plagosja e rëndë e fëmijës ndërkohë që merr pjesë në ose tek një veprimtari e WV, ose që shkaktohet drejtpërdrejt nga një person që ka lidhje me WV për shkak të një neglizhence të mundshme ose veprimesh të tjera. Zyrat WV përpiqen të raportojnë pretendimet për abuzim ose dëmtimin e mundshëm nga një person ose projekt i WV tek Mbrojtja e Fëmijëve WVI brenda 24 orëve nga njoftimi i parë nëpërmjet formularit elektronik të raportimit të Incidentit të Mbrojtjes së fëmijëve. Ndërhyrja do të zbatohet nga WVA&K në bashkëpunim me Skuadrën e Menaxhimit të Incidenteve të Mbrojtjes së Fëmijëve, përgjegjëse ndaj Këshilltarit Rajonal të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Drejtorit të Mbrojtjes së Fëmijëve të WVI.

5.4 Konfidencialiteti Publik: Njerëzit do të informohen për incidentin e mbrojtjes së fëmijëve mbi bazë të “nevojës për t'u informuar”. Emrat dhe identitetet nuk do të zbulohen jashtë grupit të caktuar të atyre që “duhet të informohen sipas nevojës”, vetëm nëse lejohet nga Këshilltari i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe/ose Komiteti i Mbrojtjes së Fëmijëve. Të gjitha ankesat do të trajtohen me seriozitet, me objektivitet, dhe me konfidencialitetin e nevojshëm. Drejtori Kombëtar dhe Drejtuesi i Programit të Mbrojtjes së Fëmijëve i WVA&K do të mbajnë përgjegjësi për përcaktimin e listës së individëve që “duhet të informohen” në secilën situatë. Këtu përfshihet edhe komunikimi me median. WVA&K rezervon të drejtën për ta zbuluar në përfundim këtë informacion për incidentet e mbrojtjes së fëmijëve tek OJF-të e tjera në përputhje me ligjet dhe sipas asaj që lejon zakoni.

5.5 Kujtesa e Privatësisë: Sipas Ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave që është vënë në zbatim në Shqipëri dhe në Kosovë për të plotësuar standardet e EU, duhet të merret miratimi i individit të interesuar (ose të prindit nëse është nën moshën 18 vjeç). Në rast të të dhënave të ndjeshme (përfshirë shëndetin, gjininë, etninë, moshën, etj.), individit i interesuar duhet të japë leje me shkrim. Për këtë arsye, lajmërimet rreth privatësisë duhet të përfshihen në të gjithë formularët

për pjesëmarrje/lejim, ku palët e interesuara informohen për emrin e kontrolluesit të të dhënave i WVA&K dhe qëllimin për të cilin këto të dhëna do të përdoren. Të dhënat duhet të mbrohen dhe nuk duhet të përdoren për qëllime të tjera. Dosjet me raportet e Incidenteve të Mbrojtjes së fëmijëve duhet të mbahen në dollapë të kyçur tek i cili kanë akses vetëm personat e autorizuar. Individui i interesuar ka të drejtën të marrë kopje të të gjitha të dhënave që mbahen rreth tij kundrejt një tarife të caktuar pasi bën një kërkesë me shkrim. Kjo duhet patur parasysh kur regjistrohet informacioni. Ka disa përjashtime të caktuara që mund të zbatohen në lidhje me sigurinë ose parandalimin e krimit. Në rast të ndonjë kërkesë serioze e cila është bazë për shqetësim, duhet të kërkonti këshillë ligjore. Verifikimi i dosjes penale dhe dokumentacionit duhet të kryhet para se individit të interesuar t'i jepet informacioni konfidencial.

Ndërkohë që WVA&K ruan konfidencialitetin e duhur për individët e përfshirë në incidentet e mbrojtjes së fëmijëve, WV mund të zbulojë informacione të përgjithshme për incidentet në mbështetje të ndërgjegjësimit dhe përgjegjshmërisë dhe për parandalimin e incidenteve të ardhshme, sikurse e kërkon ligji.

6. Programimi për Mbrojtjen e Fëmijëve

6.1 Mbrojtja e Fëmijëve si Temë Gjithëpërfshirëse: Në të gjitha programet kërkohet që fëmijët të mos dëmtohen, të veprohet në interesin më të mirë të fëmijës, dhe të përdoren mundësitë për t'i ndihmuar ata të ndihen të sigurt brenda familjeve dhe komuniteteve të tyre. Këtu përfshihet përcaktimi i mekanizmave të ankimit dhe ndërhyrjes, marrja në konsideratë gjatë përgatitjes së programit të kërcënimeve ose problemeve të mundshme lokale të mbrojtjes së fëmijëve dhe ndikimi tek partnerët për të qenë organizata më të sigurta për fëmijët.

6.2 Institucionalizimi dhe Birësimi: WV nuk e lehtëson birësimin e fëmijëve ose nuk i mbështet programet e institucioneve afatgjata përsa i përket institucionalizimit të fëmijëve.

7. Pjesëmarrja e Sigurt për Fëmijën

7.1 Parandalimi i Dëmtimit gjatë Pjesëmarrjes së Fëmijëve: WVA&K punon për të fuqizuar fëmijët (përfshirë ata më vulnerabël) si qytetarë dhe pjesëmarrës duke përmirësuar mirëqënien e tyre, dhe minimizuar çdo rrezik nga dëmtimi apo pasojë negative si rezultat i pjesëmarrjes në veprimtaritë e promovuara nga WVA&K.

7.2 Etika: Veprimtaritë ku marrin pjesë fëmijët ndërtohen dhe zbatohen në përputhje me parimet morale që kanë si përparësi kryesore të tyre interesin më të lartë të fëmijëve.

7.3 Leja e Informuar e Pjesëmarrjes së Fëmijës: Veprimtaritë ku marrin pjesë fëmijët bëhen në bazë vullnetarë dhe gjithëpërfshirëse (në veçanti për fëmijët më vulnerabël), dhe fëmijët sikurse edhe prindërit/kujdestarët ligjorë marrin vendime të informuara lidhur me pjesëmarrjen, përfshirë marrjen parasysh të rreziqeve që mund të kenë lidhje me veprimtarinë.

7.4 Udhëtimi i Fëmijës: Ndonjëherë, kur është në interesin më të mirë të fëmijës, WVA&K ndihmon nëpërmjet lehtësimit të udhëtimit të fëmijëve në evenimente, veprimtari dhe raste të tjera. Në raste të tilla, si prindërit³, kujdestarët ligjorë, entitetet ose individët që u kërkohet nga ligji, japin një leje të informuar para udhëtimit. Shëndeti, siguria dhe mirëqënia e fëmijës janë përparësitë më kryesore gjatë udhëtimit të ndihmuar nga WVA&K. WVA&K nuk lehtëson vizitat e fëmijëve jashtë vendit tek sponsori i tyre: WVA&K sigurohet që fëmijët që udhëtojnë për tek, ose kthehen nga veprimtaria e sponsorizuar nga WVA&K të jenë gjithnjë të shoqëruar nga një i rritur, që mund të jetë prindi i njërit prej fëmijëve, ose një punonjës, vullnetar i WVA&K, etj. (Për çdo udhëtim jashtë Shqipërisë ose Kosovës, ju lutem shihni Protokollin 2013 për udhëtimet jashtë vendit).

8. Organizatat Partnere

Zyra e WVA&K, në marrëveshje me organizatat partnere të cilat sigurojnë shërbime për fëmijët, do të sigurohet që politikat dhe procedurat e mbrojtjes së fëmijëve të zbatohen, duke pranuar që mungesa e politikave të tilla mund t'i vërë në rrezik fëmijët dhe World Vision-in.

Të gjitha marrëveshjet e parneritetit duhet të ketë të bashkëngjitur Politikën e MF, të kuptuar, të firmosur, që do të mbahet në një dosje nga partneri. Nëse partnerët kanë politikën e tyre për MF, ajo do të rishikohet me kujdes nga WVA&K për të përcaktuar nëse është në përputhje me Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve të WVA&K, dhe një kopje e politikës së partnerit për MF dhe do të ruhet në një dosje bashkë me marrëveshjen.

Për marrëveshjen dhe pranimin:

Unë, e kam lexuar, kuptuar dhe jam i/e angazhuar t'i respektoj Protokollin e Sjelljes së Mbrojtjes së Fëmijëve të World Vision Shqipëri dhe Kosovë 2016.

Emri, Mbiemri: _____

Firma: _____

Data: _____



Aneks 1. Protokollin e Sjelljes.docx



Aneks 2. Komunikimi, media s

³ Të dy prindërit duhet të firmosin lejen në rast se fëmijët udhëtojnë jashtë shtetit. Në rastet e tjera, një nga prindërit ose kujdestari ligjor duhet ta firmosë lejen.